

Vendim nr. 22 datë 03.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Holta Zaçaj,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 03.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (M) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MIRASH LEPURI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-455, datë 21.04.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet 27, 28, 29, 30, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim çështjen penale me nr. 734, viti 2014, në ngarkim të kërkuarit për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, dhe “Prodhimi e mbajtja

pa leje të armëve luftarake e municionit”, që parashikohen nga nenet 78/1, 22, 25 dhe 278/4 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2015-4225) 812, datë 18.09.2015, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të pandehurit Mirash Lepuri, për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 78/1,23,25 dhe 49 të K.Penal, e dënon me 13 vjet burgim. Deklarimin fajtor të pandehurit Mirash Lepuri, për veprën penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake e municionit” dhe në bazë të nenit 278/4 e 49 të K.Penal, e dënon me 7 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, konform nenit 55 të K.Penal, përfundimisht i pandehuri Mirash Lepuri dënohet me 20 vjet burgim [...]”*. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2016-943(323), datë 25.04.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit penal nr.(11-2015-4225) 812 datë 18.09.2015, për sa i përket deklarimit fajtor, cilësimit juridik të veprës penale për "Vrasje me paramendim në bashkëpunim", disponimin mbi fillimin e kohës së vuajtjes së dënimit e llojit të sigurisë të burgut, e disponimin mbi provat materiale e shpenzimet gjyqësore. Ndryshimin e po këtij vendimi sa më poshtë: Deklarimin fajtor i të pandehurit Mirash Lepuri, për veprën penale të "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit" dhe në bazë të nenit 278/2 e dënon me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për disa vepra penale e dënon të pandehurin Mirash Lepuri me 15 vjet burgim.”*

4 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-455, datë 21.04.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 11.11.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 02.12.2022, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-455, datë 21.04.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi** pretendon se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces rregullt, duke i cenuar:

6.1. *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është alogjik, absurd dhe nuk përmbush kërkesat për një vendim të arsyetuar. Ajo gjykatë ka gabuar në arsyetim kur ka vlerësuar se

pretendimet e kërkuessit nuk i referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Gjithashtu, arsyetimi i asaj gjykate është paradoksal, konkretisht në pikën 22 të vendimit të saj, kur pranon se kërkuessi në momentin e ngjarjes ka qenë në vendin e tij të punës që ndodhet 15 kilometra larg nga vendi i ngjarjes dhe nuk mund të shpjegohet se si ka qenë njëkohësisht në dy vende të ndryshme.

6.2. *Parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi provat nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Gjykata i ka dhënë prioritet provave të paraqitura nga i dëmtuari. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një analizë të plotë dhe të thellë të provave me shkeljet e kryera nga gjykata e apelit.

6.3. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykata e apelit, jo vetëm që nuk ka bërë një analizë të plotë të provave, por ajo e ka nisur procesin me bindjen se kërkuessi e ka kryer veprën penale duke anashkaluar të gjitha provat e paraqitura në gjykim.

6.4. *E drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi nuk i është dhënë mundësia dhe koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen, duke qenë se nuk është njoftuar për trupin gjykues, datën dhe orën e seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Në rastin konkret kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar. Duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 21.04.2022 që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor që ka vendosur mospranimin e rekursit, ai ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion.

9. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vëren se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-455, datë 21.04.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.11.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra jashtë afatit ligjor 4-mujor. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument se pse e ka paraqitur këtë kërkesë jashtë afatit ligjor.

12. Referuar akteve të ardhura me kërkesën, rezulton se, fillimisht, kërkuesi nuk e ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Lartë objekt kërkesë kur i është drejtuar Gjykatës. Ai e ka përmendur këtë vendim duke iu referuar vetëm numrit të tij, pa vendosur datën se kur është marrë ky vendim. Pas kërkesës së sekretarisë së Gjykatës për plotësimin e kërkesës, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë shkresën nr. 4796/1 prot., datë 27.09.2022 të Kancelarit të Gjykatës së Lartë (në përgjigje të shkresës së përfaqësuesit të kërkuesit, datë 02.09.2022 edhe kjo e paraqitur pas kalimit të afatit 4-mujor) me anë të së cilës përfaqësuesi ka marrë informacion për çështjen dhe vendimin e Gjykatës së Lartë.

13. Gjithashtu, duke iu referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se kjo e fundit, në datën 15.03.2022, ka shpallur publikisht listën e çështjeve, të cilat do të shqyrtoheshin në datën 21.04.2022, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Pas këtij njoftimi Gjykata e Lartë ka njoftuar në faqen e saj zyrtare edhe përfundimin e gjykimit për çështjen e kërkuesit, duke publikuar edhe vendimmarrjen e saj.

14. Për sa më sipër, Kolegji vëren se ka qenë vetë kërkuesi, i cili, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, përmes rekursit, ka iniciuar procesin në Gjykatën e Lartë dhe ka pasur interesin për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Paraqitja e shkresës së Gjykatës së Lartë, ku përfaqësuesi i tij është pajisur me një kopje të vendimit të asaj gjykate, nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht për këtë vendim, sepse një informacion i tillë mund të kërkohej në çdo rast dhe në çdo ditë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor.

15. Në vështrim të sa më sipër, për sa kohë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të Gjykatës, ndaj nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kritereve të tjera të pranueshmërisë.

16. Si përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.